



Adelina Theodhori

“Qendra Artizanale Margarita” - rilindja e traditës beratase

Adelina Theodhori është një 53 vjecare plot pasion, e lindur dhe e rritur në Berat - qyteti i trashëgimisë kulturore të UNESCO - i njohur për historinë e lashtë dhe zejet tradicionale. Adelina vjen nga një familje artizanësh Beratas. Në moshën 10 vjecare ajo mësoi nga gjyshja artin e qëndisjes, dhe fi lloi të kombinonte gjilpërat me fi jet shumëngjyrëshe në realizimin e motiveve mbi pëlthurë. Në vetëm disa vjet, qëndismat e Adelinës morën famë në Berat, dhe ajo nisi të marrë porositë e para të paguara për paja nusesh. Adelina studioi për t’u bërë veterinerë, por përfundoi duke bërë punë të ndryshme gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri, kur kohët ishin të vështira dhe gjetja e një pune të qëndrueshme jo e lehtë. E vetmja gjë që nuk ndryshoi në ato vite

“Margarita Artisanal Center” - Berat’s handicraft renaissance

Adelina Theodhori is a highly passionate woman of 53, born and raised in the UNESCO heritage town of Berat, known for its history and traditional crafts. Adelina was born to a family of artisans, skilled in needlework. At the age of 10, she learned from her grandmother the art of embroidery, starting to combine colored threads and needles to produce various decorative images. In just a few years’ time her needlework became outstanding and she started getting paid orders for wedding dowries. She studied to become a vet but ended up doing different jobs during the years of Albania’s transition from isolation to an open market. Times were difficult and finding employment not easy. In those challenging years, the only thing that did

ishte pasioni i Adelina's për qëndisjen, i cili shpesh bëhej burimi i të ardhurave që Adelina përpiqej të siguronte për familjen e saj.

Sot, Adelina është jo vetëm një qëndistare me përvojë, por edhe një aktiviste e përkushtuar, e cila me sakrifi ca e përpjekje të panumërta ka realizuar një prej ëndrrave të saj: hapjen e “Qendrës Artizanale Margarita” - zyrtarizuar dhe regjistruar në korrik të vitit 2015 – fi llesat e së cilës datojnë që nga shtatori i vitit 1993!

“U deshën katër muaj ece-jakesh nëpër Berat për të gjetur dhe listuar artizanët më të talentuar të qytetit. Këmbët m’u enjtën kalldrëmeve teksa trokisja derë më derë e shtëpi më shtëpi. Mbaj mend, ka pasur ditë kur më është dashur të blej fasho për këmbët e lënduara”, - thotë Adelina, me një buzëqeshje të butë në fytyrë.

Në fund të katër muajve, Adelina listoi rreth 50 artizanë, 60% e të cilëve gra, të talentuar në zeje të ndryshme, si qëndistarë, kashtë punues, dru e gur gdhendës, e argjendarë bizhush. Së bashku ata kanë marrë pjesë në panaire e ngjarje të ndryshme, brenda

not change was Adelina's passion for needlework, which often secured the only income for her family.

Nowadays, Adelina is not just an experienced artisan, but also a committed activist who has spent a lot of time, effort and money, in order to see one of her lifelong dreams become reality: the opening of the “Margarita Artisanal Center”, formalized and legally registered in July of 2015 but in the making since September 1993!

“It took countless efforts and four months of house-to-house outreach to find and map the most talented artisans of Berat. My feet got swollen by walking up and down my city's hilly streets, and knocking door-to-door. I remember there were days when I ended up at the pharmacy buying band aids to wrap around my aching feet” - says Adelina, with a soft smile on her face.

Adelina was able to list about 50 artisans, 60% of which are women, skilled in different arts, such as embroidery, straw basket making, stone and wood engraving, handmade beautiful jewelries, etc. Together



e jashtë vendit, duke mbajtur gjallë shpirtin artizan të Beratit.

Në pranverë të vitit 2015 RisiAlbania, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, organizoi në Berat konkursin “RisiTuristike” - një event për të stimuluar industrinë e turizmit - ku “Qendra Artizanale Margarita” mori pjesë me një propozim, i cili nuk u përzgjedh ndër fi tuesit. **“Nuk u mërzitëm nga ‘humbja’ ...sinqerisht; ishim të lumtur që na u dha mundësia për të ndarë me të gjithë në Berat idetë dhe produktet tona”** - thotë Adelina.

Por edhe pse nuk fi tuan një cmim, Adelina dhe miqtë e saj përfi tuan nga ata që u shpallën fi tues në konkurs! Dy prej tyre i ftuan artizanët në trajnime mbi teknikat e shitjes dhe modelet e reja artizanale, duke nënkontraktuar Qendrën Margarita për prodhim suveniresh të reja, për Qendrën e Interpretimit Turistik në Berat, e cila erdhi në jetë me mbështetjen e çmimit Risi Turistike. Si rezultat, artizanët përmirësuan aftësitë dhe rafi nuan artin e tyre në zejet përkatëse, ndërsa 40 persona u punësuan për 5 muaj, 20 prej të cilëve vajza. Shitjet e Qendrës Margarita u rritën me 40% dhe produktet aktualisht mbushin vitrinat e Qendrës së Interpretimit Turistik në Berat, nga ku turistët mund t'i blejnë e njëheresh të marrin informacion mbi traditën e vjetër dhe larminë e zejeve artizanale Beratase; ata gjithashtu mund të vizitojnë artizanët nëpër punishtet e tyre.

Për Adelinë ky është fi llimi i realizimit të një tjetër ëndrre; tradita artizanale e Beratit gjallon, ndërsa artizanët zhvillojnë më tej artin e tyre, duke jetuar prej tij, dhe duke jua pasuar këtë art brezave të ardhshëm.

they have participated sporadically in different fairs and events, keeping Berat's craft-making spirit alive.

In spring of 2015 RisiAlbania in close cooperation with the Ministry of Economy, Tourism Trade and Entrepreneurship, launched in Berat the “RisiTuristike Award”, a competition to stimulate the tourism industry in that region. The Margarita Artisanal Center submitted a proposal, but they lost. “We did not win, but ... honestly, we were not sad at all; I was happy we were given the opportunity to share with everyone in Berat the ideas and products of our Margarita Artisanal Center” - says Adelina.

But even if their proposal didn't win an Award, the artisans have benefited from those who did! Two of the “Risi Turistike Award” winners have already invited Adelina and her friends to trainings on sales techniques and new ideas and designs for handicrafts, while subcontracting them for producing new souvenirs. As a result, the artisans improved their skills and refined their art, while 40 people were employed for 5 months, 20 of whom are young women. Margarita's sales increased by 40% and the products currently showcase at the newly inaugurated Tourist Interpretation Center of Berat - which came to life with the support of the Award. The tourists who buy souvenirs receive information about the old tradition and diversity of Berat's craftsmanship; they can also visit the artisans at their workshops.

For Adelina this is the beginning of another “dream come true”: Berat's artisanal tradition kept alive, while artisans further develop their art, making a living through it, and passing it on to the next generation.